



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më _____.____.2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Shërbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS- “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit” - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.

LLOJI PROÇEDURËS- **“Procedurë e hapurmbi kufirin e lartë monetar–shërbim”**

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - **314’597’968** (treqind e katërmëdhjetëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa t.v.sh., ose 3.243.278** (tremilion e dyqind e dyzet e tremijë e dyqind e shtatëdhjetë e tete) **Euro**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitet 2025, 2026 dhe 2027.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 98341130-5 Shërbime pastrimi

Ne bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 9

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepr penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepr penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 8 Datë 23.09.2024 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-b) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika a) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit i prokuruar.

Argumentimi. Kriteri **2.2.1** është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/a, nenit 47 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi. Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën apo kontratat e lidhura me një ent publik të shoqëruar me vërtetime për realizimin me sukses të kontratës, ku të shënohen vlerat dhe afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, ***shumat dhe shërbimet e realizuara;***

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar datat, ***shumat dhe shërbimet e realizuara.***

Argumentimi. Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77 pikë 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 41 pikë 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë”, dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar; Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 ”Per mbrojtjen e mjedisit”; Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”. Licenca e kerkuar me kodin III.2.B eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane te klasifikuara si jo te rrezikshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë një ambjent të përshtatshëm për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve në pronësi/qera/forme tjeter të parashikuar nga ligji apo të paraqesë një kontratë shërbimi me të trete. Ambjenti duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në specifikimet teknike për kryerjen e këtij shërbimi.

Për të vertetuar sa më sipër duhet të paraqitet:

Nëse ambjenti është në pronësi duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë.

Nëse është me qira duhet të paraqitet kontrata e qirase shoqëruar me dokumentacionin e përkatës të pronësive së qiradhenesit. Kontrata e qirase ku të ketë të përcaktuar objektin dhe afatin e kontratës, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Nëse operatori do të lidhë një kontratë shërbimi me të trete duhet të paraqesë kontratën e shërbimit ku të jetë përcaktuar objekti dhe afati i kontratës, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në të nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; dhe nenin 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ambjenti është kerkuar bazuar në shërbimin e kerkuar për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve në përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike, ku ndër të tjera përcaktohet: *Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenieret çdo natë në vendin e përcaktuar nga ai dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje.*

2.3.4- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

- a) Mjet teknologjik transporti vetëshkarkues, për largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton -**3 (tre) copë**.

- b) Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, per largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5 - 8 ton - **1 (një) copë**;
- c) Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, per largimin e mbetjeve urbane, me kapacitet mbartes deri 3.5 ton- **3 (tre) copë**;
- d) Mjet transporti me vinç me kapacitet mbartes deri 3.5 ton - **2 (dy) copë**
- e) Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës deri 3.5 ton - **1 (një) copë**
- f) Mjet për larjen e rrugëve, autobot, i pajisur me pompë për freskimin (lagien) e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10 m³ - **1 (një) copë**.
- g) Operatori ekonomik duhet te kete dhe keto mjete rezerve:
 - Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, per largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton - **1 (një) copë**;
 - Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, per largimin e mbetjeve urbane, me kapacitet mbartes deri 3.5 ton - **1 (një) copë**
 - Mjet transporti me vinç me kapacitet mbartes deri 3.5 ton - **1 (një) copë**

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruar në pronësi qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Per mjetet e deklaruar me qira qe shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë, dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qirasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi, operatori ekonomik, duhet të paraqese kontraten e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (original ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit te porositur (emertimin teknik), llojin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.

Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.

- Per mjetet e paregjistruara ne Republiken e Shqiperise, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerje sipas njerit prej rasteve ne vijim:
 - (i) Me pronarin e automjeteve.
 - (ii) me koncesionarin ose ndermjetesin ne rastin kur ka periudhe tranzitore per te pasur te drejten e posedimit te mjeteve.
 - (iii) Me prodhuesin ose koncesionarin ne rastin e paraqitjes ne proceduren e prokurimit me mjetet e reja.

Ne te gjitha rastet subjekti duhet te paraqese dokumentacionin e nevojshem, i cili verteton se subjekti qe merr persiper furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit te vendit te origjines, te drejten per te pasur ne pronesi ose gezuar te drejten e shitblerjes se mjeteve te paraqitura.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri dhe lloji i makinerive dhe pajisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në sasine dhe natyrën e shërbimit. Për këtë qëllim është ngritur edhe grupi i punës, i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe ka perlllogaritur fondin limit. Ky grup bazuar në territorin ku do të shtrihet ky shërbim, në sasine dhe llojin e mbetjeve, ka përcaktuar

numrin dhe volumin e konteniereve, mjetet qe duhen per largimin e mbetjeve, fshirjen dhe freskimin e rrugeve.

1. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton - **3 (tre) copë + 1 rezerve**. Bazuar ne kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve qe do te transportojne (50 ton ne dite), numrin e rrugeve (2 rruge ne dite), kapacitetin dhe numrin e konteniereve qe do te perpunohen (gjithsej 558 cope) AK ka llogaritur qe per te kryer sherbimin duhen **3** mjete teknologjike transportuese me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, ndersa **1** mjet duhet rezerve per zevendesim ne rast se eshte me defekt ndonje mjet.

2. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5 - 8 ton - **1 (nje) copë**. Eshte kerkuar per grumbullimin e mbeturinave ne rruge ku nuk ka mundesi te futet mjeti me kapacitet 10 ton. Bazuar ne kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve qe do te transportoje (8 ton ne dite), numrin e rrugeve (2 rruge ne dite), kapacitetin dhe numrin e konteniereve qe do te perpunohen (gjithsej 142 cope) AK ka llogaritur qe per te kryer sherbimin duhet **1** mjet teknologjik transportues me kapacitet mbajtës 5-8 ton.

3. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, me kapacitet mbartes deri 3.5 ton - **3 (tre) copë + 1 rezerve**. Keto mjete jane kerkuar per largimin dhe transportin e mbetjeve urbane derë më derë, direkt nga familjaret. Eshte kerkuar deri 3.5 ton pasi grumbullimi i mbeturinave do te behet ne rruge ku nuk mund te futet mjet me kapacitet me tonazh me te madh. Bazuar ne kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve qe do te transportojne (8 ton ne dite), numrin e rrugeve (1 rruge ne dite), numrin e zonave te banuara sipas lagjeve si dhe numrin e familjeve AK ka llogaritur qe per te kryer sherbimin duhen **3** mjete teknologjike transportuese me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton, ndersa **1** mjet duhet rezerve per zevendesim ne rast se eshte me defekt ndonje mjet.

4. Mjet teknologjik transporti me vinç me kapacitet mbartes deri 3.5 ton - **2 (dy) copë + 1 rezerve**. Keto mjete jane kerkuar per largimin dhe transportin e mbetjeve inerte, mbetjeve voluminoze dhe transportin e konteniereve per larje. Bazuar ne kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve inerte qe do te transportojne (2 ton ne dite), sasine e mbetjeve voluminoze qe do te transportojne (2 ton ne dite) numrin e rrugeve (1 rruge ne dite), numrin e konteniereve qe do te transportohen per larje (10 cope çdo dite), numrin e konteniereve rreth te cilave do te largohen keto mbetje (357), AK ka llogaritur qe per te kryer sherbimin duhen **2** mjete teknologjike transportuese me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton, ndersa **1** mjet duhet rezerve per zevendesim ne rast se eshte me defekt ndonje mjet.

5. Makine per larjen e rrugeve (autobot) i pajisur me pompë për freskimin (lagien) e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10 m³ - **1 (një) copë**. Bazuar ne siperfaqet e planifikuara per freskim (lagie), sasine e ujit per 1 m² (0,46 lit/m²), numrin e cikleve (1 here ne dite - 4 ore paradite), kohen e zbrasjes se autobotit, AK ka llogaritur qe per te kryer sherbimin duhet nje Autobot me kapacitet mbajtes jo më pak se 10 m³.

6. Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem

spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës deri 3.5 ton per fshirjen e rrugeve te parashikuara per kete sherbim. AK ka percaktuar ne strukturen e sherbimit te pastrimit edhe fshirjen e disa rrugeve me autofshese.

2.3.5- Nje punësim mesatar prej **95** (nëntëdhjetë e pesë) punonjës, per 3 muajt e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularet e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqise punetore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Argumentimi. Kërkesa eshte bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

Numri i punonjesve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në strukturen dhe natyren e sherbimit. Per kete qellim eshte ngritur edhe grupi i punes, i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe ka perllogaritur fondin limit. Ky grup bazuar ne territorin ku do te shtrihet ky sherbim, ne sasine dhe llojin e mbetjeve, ka percaktuar numrin dhe volumen e konteniereve, mjetet qe duhen per largimin e mbetjeve, fshirjen dhe freskimin e rrugeve. Mbi bazen e kesaj strukture eshte llogaritur edhe numri i punonjesve per cdo sherbim sipas zerave te preventivit, e konkretisht:

1. Numri i mjeteve te domosdoshme per kryerjen e sherbimit eshte 11. AK ka llogaritur minimumi **10 punonjes drejtues mjeteshe**, duke pasur parasysh qe sherbimi i freskimit fillon ne muajin prill, pra OE ka mundesi qe ta siguroje edhe me vone. Numri i mjeteve eshte percaktuar dhe argumentuar ne kriterin 2.3.4.

2. Numri i punonjesve, te cilet do te jene ne dispozicion te mjeteve, duke perjashtuar drejtuesit e mjeteve, do te jete **22 punonjes**, i ndare si me poshte:

Numri i punonjesve per cdo mjet teknologjik 5 dhe 10 ton per largimin e mbetjeve eshte llogaritur te jete 3 punonjes dhe per 4 mjete duhen **12 punonjes**.

Numri i punonjesve per cdo mjet 3.5 ton qe do te perdoren per largimin e mbetjeve nga shtepite e qytetareve, transportin e mbetjeve voluminoze dhe konteniereve, si dhe transportin e mbetjeve inerte dhe mbetjeve te riciklueshme eshte llogaritur te jete 2 punonjes dhe per 5 mjete duhen **10 punonjes**.

3. Numri i punonjesve, te cilet do te bejne fshirjen me krahe te rrugeve, shesheve dhe trotuareve do te jete **29 punonjes**. Nga perlllogaritjet norma ditore e fshirjes me krahe eshte $8500\text{m}^2/\text{dite}$ per nje punonjes me frekuence per cdo dite. Siperfaqja e planifikuar per kete sherbim per 755 dite eshte $185\,831\,925\text{m}^2$. Pra duhen 29 punonjes per kryerjen e sherbimit cdo dite ($185\,831\,925/755=246\,135/8500=29$).

4. Numri i punonjesve, te cilet do te bejne fshirjen e pjesshme te rrugeve dhe trotuareve me frekuence per cdo dite do te jete **20 punonjes**. Nga perlllogaritjet norma ditore e fshirjes se pjeseshme eshte $17000\text{m}^2/\text{dite}$ per nje punonjes me frekuence per cdo dite. Siperfaqja e planifikuar per kete sherbim per 755 dite eshte $253\,433\,115\text{m}^2$. Pra duhen 20 punonjes dhe per kryerjen e sherbimit cdo dite ($253\,433\,115/755=335\,673/17\,000=20$).

5. Numri i punonjesve, te cilet do te bejne fshirjen e pjesshme te rrugeve dhe trotuareve me frekuence 6 dite ne jave, gjithsej 646 dite do te jete **18 punonjes**. Nga perlllogaritjet norma ditore e fshirjes se pjeseshme eshte $17000\text{m}^2/\text{dite}$ per nje punonjes. Siperfaqja e planifikuar per kete sherbim per 646 dite eshte $193\,823\,256\text{m}^2$. Pra duhen 18 punonjes dhe per kryerjen e sherbimit ($193\,823\,256/646=300\,036/17\,000=18$).

6. Drejtuesi teknik i sherbimit.

7. Inxhinieri i mjedisit/eksperti ne fushen e mjedisit.

2.3.6- Operatori duhet te percaktoje me ane te nje deklarate nga Administratori i Shoqerise, Drejtuesin Teknik (pergjegjesin e sherbimit), per te cilin duhet te paraqese: Kontrate pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Argumentimi. Kriteri **2.3.6** eshte vendosur ne baze te pikes 4, te nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin teknik te nevojshmem per ekzekutimin e objektit te prokurimit. Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e ketij sherbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar staf teknik si me poshte:

- 1 (një) nje punonjes te diplomuar ne Inxhinier Mjedisi ose diplome ekuivalente ne fushen mjedisore ose 1 Ekspert te certifikuar ne fushen e Mjedisit.

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, diploma/çertifikata si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Çertifikata/diploma/deshmia duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH", i ndryshuar.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet, të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Argumentimi. Kriteri 2.3.7 është vendosur bazuar në piken 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenin 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi. Është kërkuar Inxhinier Mjedisit ose me diplome ekuivalente në fushën mjedisore ose 1 Ekspert i certifikuar në fushën e Mjedisit nisur nga nga përvoja e mëparshme si dhe legjislacioni për mjedisin. Është vendosur periudha prej 3(tre) muajsh pasi konsiderohet e mjaftueshme që ofertuesi të vertetojë që ka një vazhdimësi në aktivitetin e perditsëm dhe angazhimin e strukture së stafit drejtues.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.9 Operatoriekonomiktëketënëstafin e tij:

- 1 (një) punonjes I pajisur me certifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa është vendosur bazuar në nenin të 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, indryshuar; nenin 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; si dhe të ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar. Me anë të këtij

kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e shërbimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet: ”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Në nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e 720 kontenierëve të mbetjeve urbane në perputhje me specifikimet teknike, nga të cilët 700 për të garantuar grumbullimin e mbetjeve urbane për çdo ditë në të gjithë zonën e kontratës, si edhe 20 kontenierë të mbetjeve urbane rezerve. Për të vërtetuar disponimin e kontenierëve operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës ose faturë zhdoganimi në emër të vet ose të qiramarrësit (në rastin kur merret me qira). Në rast se janë me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të kontenierëve, i cili duhet të jetë sa kohezgjatja e marreveshjes kuader.

Në rast se operatori ekonomik disponon kontenierët në një formë tjetër të ndryshme nga mënyrat e parashikuara më lart si dhe të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar disponimin e tyre.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i konteniereve është llogaritur në baze të nevojave dhe prodhimit të mbetjeve nga qytetaret, zona e shërbimit të pastrimit me një shtrirje territoriale prej 1530 ha, si dhe distanca midis vend-grumbullimeve. Për këtë qëllim janë përgatitur edhe hartat duke vendosur koordinatat për çdo vend-grumbullim. Numri i konteniereve rezerve është llogaritur duke pasur parasysh që për çdo ditë duhen zëvendësuar 10 konteniere që do të lahen dhe dezinfektohen, si dhe 10 konteniere duhet të jenë rezerve për të zëvendësuar kontenieret në rast dëmtimesh apo kur kanë nevojë për riparime.

2.3.11. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se në rast se shpallet fitues mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve dhe kontenierëve.** Verifikimi fizik do të bëhet përpara vlerësimit të ofertave.

Përsa mesiper, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë adrese të sakta të vendodhjes së mjeteve dhe konteniereve që janë në pronësi apo që janë marrë me qira apo formë tjetër disponimi për këtë objekt prokurimi, me qëllim verifikimin e tyre përpara vlerësimit të ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 41, pika 4, gërma ç, dhe nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Duke qenë se disponimi i mjeteve dhe pajisjeve bëhet me deklaram, autoriteti kontraktor ka të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, prandaj është kërkuar edhe deklarimi nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës deklarimi i adresës së vendndodhjes së mjeteve dhe konteniereve.

Shënim:

1. Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën angleze si dhe t’i certifikojnë me vulën ”Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e

ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

2. Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, në rastin e ofertuesve të huaj, do të paraqiten dokumenta të lëshuar sipas legjislacionit të vendit të origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklarata me shkrim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike dhe perlllogaritje e fondit limit janë hartuar nga grupi i punës duke u bazuar në legjislacionin e fushës për menaxhimin e mbetjeve e konkretisht në ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i ndryshuar; si dhe të VKM Nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për Koston e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.

Vizioni :

Zbatimi i politikave të Qeverisë Shqiptare :

- Për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit, të Njësisë së Qeverisjes Vendore Bashkia Elbasan.
- Mbrojtjen e burimeve tona natyrore nga ndotja dhe degradimi.
- Promovimi i vlerave mjedisore
- Dhe me kryesorja mbrojtja e shëndetit të komunitetit dhe mjedisit.

Objektivat :

Në zbatim të Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane” dhe politikave të zhvillimit të Bashkisë Elbasan kërkohet të arrihen:

- Vënia në zbatim të masave dhe kriterëve të përcaktuar në të gjithë kuadrin ligjorë
- Njohja e modeleve të konsoliduara mbi Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe konkretisht në realizimin e shërbimit të pastrimit të qytetit si dhe transportin e largimin e mbetjeve urbane për në Landfill.
- Ngritjen e sistemit të riciklimit të mbetjeve.

- Të edentifikohen mundësite për të reduktuar koston e grumbullimit, transportit dhe largimit të mbetjeve.
- Përcaktimin e rregullave rreth përgjegjësi të prodhuesëve të mbetjeve inerte dhe ndërtimore.

Në bazë të Urdhërit Administrativ me Nr.375 Prot. datë 05.06.2025 “ *Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit tekniko – ekonomik, në drejtim të përgatitjes dhe të përlllogaritjes së koston për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve*”; si dhe për vazhdimësinë e kryerjes së shërbimit të pastrimit në Qytet, jemi bazuar në:

- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.10431 date 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr.10463 date 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane.
- V.K.M nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Vendimi për disa ndryshime në vendimin nr.234 datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.
- Vendim nr. 242, datë 20.4.2023 për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të këshillit të ministrave, “për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.
- Vendimnr. 113, datë 1.3.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.
- V.K.M nr.3538 datë 22.09.2021 ‘Për disa shtesa në vendimin Nr. 687 datë 29.07.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.
- V.K.M nr.29 date 29.04.2008 ‘Mbi rregulloren për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit.
- V.K.M nr.629 datë 15.07.2015 ‘Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.
- Udhëzimi Nr. 8 Dt. 09.03.2018” Per Amortizimin e mjeteve”

Grupi i punës fillimisht nisi nga puna përgatitore duke :

1. Përcaktuar e ndjekur të gjitha praktikat bashkëkohore dhe ligjore në hartimin e procedurave tekniko – organizative .
 2. Grumbullimin e përpunimin e të dhënave mbi realizimin e shërbimit të pastrimit.
 3. Përcaktimin e volumeve të punës për çdo proces shërbimi pastrimi
 4. Analizën e koston për çdo Njësi Shërbim
 5. Përlllogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme që kërkon ky shërbim publik,duke u bazuar në fondin limit për këtë qëll
- Për rrjedhojë, grupi i punës gjatë ushtrimit të detyrave funksionale filloi punën duke u orientuar në:
- Metodologjinë për studimin e përpunimin e të dhënave,duke u bazuar në V.K.M Nr. 319 datë 31.05.2018 në të cilin përcaktohen dispozitat e përgjithshme tëpërlllogaritjeve dhe të menaxhimit.
 - Udhëzuesin dhe modelet të përcaktuar sipas nenit 1 të këtij Vendimi, nga ku ngarkohen të gjithë Njesitë e Vetëqeverisjes Vendore të zbatojnë këto modele

Me qëllim :

1. Minimizimin e sasisë së mbetjeve urbane të gjeneruara.

2. Ripërdorimin dhe riciklimin.
3. Grumbullimin, trajtimin dhe rehabilitimin në landfill.

Nga ku :

- Kemi bërë studimin dhe kemi kërkuar të dhënat e përgjithshme për çdo Lagje të qytetit.
- Kemi përpunuar të dhëna mbi Investimet kapitale (mjete transporti e kontenierë)
- Koston operative (mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera)
- Koston e amortizimit
- Përlogaritjen e koston totale të shërbimit.

Për të arritur saktësinë, në përpunimin e të dhënave në programin e menaxhimit kemi përfshirë dhe elementë të tjerë të domosdoshëm si:

- Testimi i tregut, duke vlerësuar çmimin e çdo produkti që ka të bëjë me shpenzimet e trajtimit të personelit përkatës (shoferë e puntorë, fshesarë e mirëmbajtës) të domosdoshëm në kryerjen e proceseve të shërbimit të pastrimit në tërësi.
- Njëkohësisht, në bazë të VKM u bë përpunimi i të dhënave mbi përcaktimin i pagës minimale
- Në monitorimin e kontrollin e çdo procesi shërbimi pastrimi për të mundësuar, vlerësuar e përcaktuar çdo element teknik e profesional, që përfshihet në operacionet e punës, duke synuar kryerjen e tij; në respektim të volumeve të punës dhe specifikimeve teknike.

Të gjithë elementët e këtij program menaxhimi konsistojnë në përcaktimin të:

1. Zonës së Qytetit, (Lagjet) dhe sipërfaqeve urbane, në të cilën do të kryhen të gjithë proceset e shërbimit të pastrimit të qytetit dhe transportin e largimin e mbetjeve urbane.
2. Strukturën e shërbimit të pastrimit, në të cilën janë përfshirë ato shërbime pastrimi që bëjnë të mundur realizimin e objektivave të vendosura, si më lart.
3. Eksperimentimin e monitorimit për kryerjen e çdo procesi shërbimi të përcaktuar në Strukturën e Shërbimit, për të vendosur mbi sasinë e volumit të punës dhe kohën e domosdoshme për kryerjen e këtij volumi.
4. Përcaktimin të numrit të punonjësve për çdo shërbim pastrimi.
5. Përcaktimin të automjeteve teknologjike dhe të thjeshta të transportit të mbetjeve urbane
6. Përcaktimin të numrit të domosdoshëm të kontenierëve të mbetjeve urbane sipas Zonës së Shërbimit dhe nevojave të komunitetit.
7. Përcaktimin dhe monitorimin i procesit të shërbimit të larjes dhe dekontaminimit të kontenierëve të mbetjeve urbane, për mënyrën e vendosjes së vendit ku do të kryhet ky proces, si dhe mjetet e paisjet të domosdoshëm për realizimin e tij.
8. Përcaktimin të vendeve të grumbullimit të mbetjeve urbane, respektivisht dhe numrin e kontenierëve për çdo vend -grumbullim
9. Studimit dhe përgatitjes së hartave përkatese, në të cilat janë përfshirë të gjithë elementët e shërbimit të pastrimit.

M E T O D O L O G J I A

Qëllimi:

- Hartimi i një Metodologjie në mënyrë që të përftojë një udhëzues praktik për të ushtruar përgjegjësitë në çështjet e menaxhimit vendor të mbetjeve.
- Përmirësimin e praktikave financiare të menaxhimit të mbetjeve.

- Organizimin e strukturave organizative, monitorimin dhe vlerësimin duke respektuar dispozitat ligjore të kontraktimit.

Objektivi:

- Të ofrojë një studim dhe udhëzues të plotë dhe efektiv.
- Të shpjegojë mënyrën e kryerjes së hapave të planifikimit dhe menaxhimit.

Për rrjedhim, Sistemi standart i llogaritjes së kostos për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane për Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të bazohet në këto dy shtylla kryesore shërbimi:

- Grumbullimin, transportin e largimin e mbetjeve urbane, shërbimi më i rëndësishëm, i cili përbën këto hallka:
 1. Të dhëna të përgjithshme për Njësinë e Qeverisjes Vendore
 2. Koston operative (mirëmbajtje, transport dhe personeli)
 3. Koston e amortizimit
 4. Koston administrative
 5. Përlllogaritja e kostos totale.
- Strukturën e shërbimit të pastrimit të qytetit e cila përbën këto procese shërbimi:
 1. Fshirjen e rrugëve trotuareve e shesheve me krah
 2. Fshirjen e pjesshme të rrugëve, trotuareve e shesheve
 3. Freskimin (lagjeve) e rrugëve
 4. Larjen dhe dezenfektimin e kontenierëve të mbetjeve urbane.
 5. Largimin e Mbetjeve urbane, inerte, derë më derë dhe voluminoze.

Referuar metodologjisë, grupi i punës ka parashikuar dhe vlerësuar këto faktorë të domosdoshëm që lidhen me zbatimin e shërbimit si:

- a. Zona e shërbimit të shtrihet në një territor prej 1530 Ha.
- b. Përcaktimi i vend – grumbullimeve të mbetjeve urbane, respektivisht dhe numrin e kontenierëve të bëhet në bazë të sasisë së gjeneruar të mbetjeve dhe duke garantuar shërbimin e transportit dhe largimit të tyre.
- c. Operatori ekonomik do të sigurojë dhe garantojë numrin e domosdoshëm të mjeteve teknologjike e të thjeshta për transportin dhe largimin e mbetjeve si dhe 700 copë kontenierë për grumbullimin e mbetjeve urbane.
- d. Për përcaktimin e vend-grumbullimeve dhe numrin e kontenierëve, kemi analizuar :
 - Plotësimin dhe zgjidhjen optimale të nevojave të komunitetit.
 - Numrin e familjeve, banorëve, institucionet e bizneset.
 - Intensitetin e zonave të banuara.
 - Vendosjen e objektivave për arritjen e një performace në kryerjen e shërbimeve.
- e. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme, kemi analizuar çdo element të kostos për çdo proces shërbimi duke i përshtatur ato me kërkesat tekniko – ekonomike si dhe për garantimin e arritjeve të standarteve bashkëkohore në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane si:
 - Vlerësimin sa më real të sasisë së gjeneruar të mbetjeve urbane dhe inerte.
 - Shpenzimet për procesin e transportimit e largimin e mbetjeve urbane dhe inertedo të përlllogariten në bazë të peshimit për çdo mjet e çdo rrugë, konfirmuar me Fletët e Peshimit apo Faturat e pranimit në Landfillit, të cilat do të dorëzohen pranë Autoritetit kontraktorë në mbarim të çdo dite pune.

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel: 00355 54 400152
email: Bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al*

- Operatori ekonomik të garantojë numrin dhe gjëndjen teknike dhe funksionale të mjeteve teknologjike si dhe ato të thjeshta.
- Monitorimin dhe vendosjen e akteve normative për çdo operacion pune në kryerjen e shërbimeve të pastrimit si ;fshirje me fshesë, mirëmbajtje, freskim të rrugëve e tjerë, duke përcaktuar qarte detyrimet në zbatim të specifikimeve teknike gjatë kryerjes së tyre.
- Studimin dhe planifikimin e rrugëve të cilat domosdoshmërisht kërkojnë shërbime pastrimi, duke përcaktuar sipërfaqet dhe volume të punës për çdo rrugë, si dhe në përgatitjen e hartave përkatëse në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës.
- Për përllogaritjen e shpenzimeve vjetore për kryerjen e shërbimit; Transportit dhe largimit të mbetjeve urbane, me mjete teknologjike apo të thjeshta, ju kemi referuar në mënyrë analitike, tipit të mjetit, karakteristikave të veçanta, kapacitetit, numrit të nevojshëm që kërkon ky shërbim pastrimi.

NJESIA E PROKURIMIT